



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 133

Tiranë – E enjte, 16 korrik 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11543, datë 13.7.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7911
Dekret i Presidentit nr. 11544, datë 13.7.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7911
Dekret i Presidentit nr. 11545, datë 14.7.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7912
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 15.7.2020	Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.....	7912
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 2, datë 8.7.2020	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 6.5.2019 “Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara”	7912
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 19, datë 22.5.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”	7913
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 160, datë 8.7.2020	Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit.....	7914

**DEKRET**

Nr. 11543, datë 13.7.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sihana Burim Hoxha Shala (Hoxha)
2. Drin Vehbi Ejupi
3. Nexhat Ismet Islami
4. Kimete Ilaz Kryeziu (Krasniçi)
5. Bekim Ejup Kryeziu
6. Arife Sabit Kryeziu (Kadriu)
7. Shkumbin Ejup Kryeziu
8. Elsa Bekim Kryeziu
9. Dijar Sylë Nikqi
10. Serbeze Selami Osmani (Ahmetaj)
11. Riza Mustaf Likaj
12. Luan Mustaf Likaj
13. Esat Beçë Likaj
14. Albert Beqë Likaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11544, datë 13.7.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Brahim Idriz Mehmetaj
2. Feride Gani Mehmetaj (Gashi)
3. Hana Brahim Mehmetaj
4. Shqiponjë Brahim Mehmetaj
5. Vullnet Brahim Mehmetaj
6. Diana Brahim Mehmetaj
7. Fahredin Nazmi Vërbovci
8. Astrit Fahredin Vërbovci
9. Dervish Rasim Tahiri
10. Ajete Rrustem Tahiri (Rrustemi)
11. Egzon Dervish Tahiri
12. Ermal Dervish Tahiri
13. Visar Idriz Morina
14. Arben Durak Fondaj
15. Elmi Rexhep Reçica
16. Luca Lorenzo Turi
17. Murat Hasan Tahiri
18. Doruntina Hysni Lekaj (Gashi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

**DEKRET****Nr. 11545, datë 14.7.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Afrim Ruhan Pacolli
2. Albana Qerim Pacolli (Gashi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**AKT NORMATIV
Nr. 29, datë 15.7.2020**

**PËR NJË SHITESË NË AKTIN
NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUJDHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas pikës 22, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 23, me këtë përmbajtje:

“23. Në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare duhet të përdoret barriera mbrojtëse (maskë), sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Mospërdorimi i barrierës mbrojtëse (maskë) nga individët në ambiente të mbyllura, publike dhe tregtare, dënohet me gjobë në masën 2 000 (dy mijë) lekë. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj pike janë inspektoratet përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për individët në ambientet publike dhe tregtare, ndërsa Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për individët në transportin publik dhe në mjedise të tjera të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë.”.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.7.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 1, DATË 6.5.2019 “PËR
PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË
NDARJES SË KUOTAVE VJETORE
TË IMPORTIT TË SUBSTANCAVE
TË KONTROLLUARA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 35 dhe të nenit 70, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe të pikës 1, të kreut VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca”,



UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1, datë 6.5.2019 “Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 12 ndryshon si më poshtë:

“Autorizimi për pajisje me kuotë importi të substancave ozonholluese është i vlefshëm nga data e miratimit të tij deri në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Një kopje të autorizimit “Kuotë importi të substancave të kontrolluara”, Ministria ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”.

2. Në paragrafin e dytë, të pikës 2 (dy), të shtojcave 1/a dhe 1/b të këtij udhëzimi, togfjalëshi “Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (kodi UNIK)”, hiqet.

3. Pika 11 e shtojcës 1/a të këtij udhëzimi, ndryshon si më poshtë:

“Autorizimi për pajisje me kuotë importi të substancave ozonholluese është i vlefshëm nga data e miratimit të tij deri në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik”.

4. Autorizimet e miratuara për vitin kalendarik 2020 janë të vlefshme deri në fund të vitit kalendarik.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

UDHËZIM
Nr. 19, datë 22.5.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 1917, DATË 1.9.2014
“PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION
TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “b” ndryshon me këtë përmbajtje:

“b) Të llogarisë shumën e tarifës kombëtare që duhet të paguhet në buxhetin e shtetit për çdo shoqëri ajrore, mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve dhe në përputhje me vlerën e biletave të shitura, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.”.

- Shkronja “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Për zbatimin e paragrafit “b” të kësaj pike, TLA-ja detyrohet të rakordojë dhe të faturojë brenda datës 5 të muajit pasardhës me secilën nga shoqëritë ajrore, tarifën 10 euro/pasagjer për kalimin me avion të RSH-së, për muajin paraardhës bazuar në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve për muajin paraardhës (biletën e udhëtimit).

TLA-ja mban aktin e rakordimit me secilën shoqëri ajrore ku evidentohet numri i pasagjerëve që kanë kaluar kufirin, numri dhe vlera e biletave të udhëtimit dhe llogaritjet për vlerën përkatëse të tarifës kombëtare që secila shoqëri ajrore detyrohet t’i paguajë TLA-s si agent, person përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit të kësaj të ardhure prej tarifës. Rakordimi do të merret i mirëqenë dhe do të konsiderohet i bërë me lëshimin e faturës nga TLA-ja për shoqëritë ajrore. Aktrakordimi i mbajtur dhe fatura e lëshuar nga TLA-ja për shoqëritë ajrore, përmban detyrimin e tarifës për të cilin TLA-ja si agent është përgjegjës të llogarisë, të arkëtojë dhe të paguajë (të transferojë) në buxhetin e shtetit.

- Shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

“d) Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit (biletave të udhëtimit) të pasagjerëve dhe këto dokumente arshivohen dhe janë në ruajtje nga TLA-ja.”.

- Shkronja “e” ndryshon me këtë përmbajtje:

“e) Shoqëritë ajrore brenda datës 10 të të njëjtit muaj, paguajnë detyrimin për shumën e tarifës për t’u paguar sipas faturës dhe aktit të rakordimit me TLA-në, në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, e cila e transferon atë në buxhetin e shtetit brenda datës 15 të muajit.”.



- Shkronja “g” riemërtohet “f” dhe ndryshon me këtë përmbajtje:

f) TLA-ja detyrohet të deklarojë dhe të transferojë, në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, brenda datës 15 të të njëjtit muaj për muajin paraardhës shumat e faturuara për shoqëritë ajrore, sipas “Formularit të deklarimit të tarifave kombëtare”, bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”.

- Shkronjat “f” dhe “h” shfuqizohen.

2. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi 1, pika 4, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Shoqëritë ajrore, të cilat kanë përgjegjësinë që të arkëtojnë prej pasagjerëve nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferojnë shumat e arkëtuara në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, ngarkohen me detyrat e mëposhtme:”.

- Në shkronjën “b”, në fund të fjalisë, shtohet togfjalëshi: “...si pjesë e çmimit të biletës.”.

- Shkronja “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Të rakordojnë me TLA-në për tarifën e faturuar për muajin paraardhës, brenda datës 5 të muajit pasardhës dhe të transferojnë për llogari të TLA-së shumat e faturuara, brenda datës 10 të muajit.”.

3. Në pikën 6, togfjalëshi “...tarifave që ka arkëtuar...”, zëvendësohet me togfjalëshin, “...tarifave që ka faturuar...”, dhe togfjalëshi “...95% të shumës së arkëtuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “...95% të shumës së faturuar.”.

4. Pika 7 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Për mosrespektim nga TLA-ja të detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, zbatohen sanksionet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 10 të ligjit nr. 9985, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, si dhe të udhëzimeve në zbatim të tyre.”.

5. Paragrafi 8, me përmbajtjen “Për mosrespektim, nga degët e shoqërive të huaja ajrore në Shqipëri, si dhe nga shoqëritë ajrore vendëse, të detyrimeve të përcaktuara në dispozitën 4, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, për këto subjekte, zbatohen sanksione në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 160, datë 8.7.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË PROKURORIT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 2, germa “a” dhe 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 dhe nenin 46, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullore për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETAR
Gent Ibrahimi



RREGULLORE

MBI KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË PROKURORIT

KREU I HYRJE

Neni 1 Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të krijojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për të siguruar rregulla të njëjta për prokurorët, duke garantuar parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit në rastin e zbatimit të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve, kriterëve dhe procedurave për transferimin e përkohshëm të prokurorëve në pozicione të lira të përkohshme, të krijuara në sistemin e prokurorisë, në zbatim të nenit 44 dhe nenit 46, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë magjistratët që ushtrojnë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit në Republikën e Shqipërisë të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Prokuroria në nevojë” nënkupton prokurorinë në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj;

b) “Pozicion i lirë i përkohshëm” nënkupton rastin kur prokurori që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion;

c) “Pëlqim” është çdo shfaqje vullneti e materializuar e subjektit të kësaj rregulloreje, ku identifikohet pranimi i tij për transferimin e përkohshëm në një prokurori të caktuar;

ç) “Transferim në një pozicion të lirë të përkohshëm” është lëvizje e përkohshme e prokurorit për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në prokurorinë nga vjen në një pozicion të lirë të përkohshëm në një prokurori tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë nëse plotëson kriteret për atë pozicion;

d) “Mungesa e prokurorëve të disponueshëm në skemën e delegimit” nënkupton rastin kur në skemën e delegimit nuk ka prokurorë të caktuar apo kur prokurorët e caktuar janë në pamundësi ligjore për ushtrimin e funksionit;

dh) “Prokuroria me ngarkesë më të ulët” nënkupton zyrën, prokurorët e së cilës kanë ngarkesën më të ulët referuar të dhënave zyrtare më të fundit të Prokurorit të Përgjithshëm;

e) “Prokuroria nga vjen” nënkupton prokurorinë ku prokurori është caktuar në detyrë në mënyrë të përhershme;

ë) “Prokurori me përvojën më të pakët në atë prokurori” nënkupton prokurorin e prokurorisë nga ku do të bëhet transferimi, i cili ka përvojën më të pakët si prokuror në të njëjtën shkallë prokurorie.

Neni 5

Parimet dhe kriteret e transferimit të përkohshëm të prokurorit

1. Transferimi i përkohshëm i prokurorit kryhet vetëm kur nevojat e prokurorisë nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit.

2. Transferimi i përkohshëm i prokurorit kryhet vetëm atëherë kur në prokurorinë në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm.



3. Transferimi i përkohshëm i prokurorit nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në prokurorinë nga vjen, çmohet nga Këshilli se, është më i madh se dobia që ai pritët të sjellë në prokurorinë ku do të transferohet. Për këtë qëllim, Këshilli, në çdo rast merr paraprakisht mendimin e drejtuesit të prokurorisë ku prokurori është i caktuar në mënyrë të përhershme.

4. Transferimi i përkohshëm, si rregull, bëhet ndërmjet prokurorëve nga prokuroria me ngarkesë më të ulët, duke filluar ndërmjet prokurorive më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apeli me prokurorinë në nevojë. Përrjashtimisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e prokurorive me ngarkesë më të ulët, transferimi mund të bëhet nga prokurorët e prokurorive të tjera me ngarkesë më të ulët sipas radhës, por, në çdo rast, duke respektuar parimin sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se ka më shumë se një prokuror që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një prokurori konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të prokurorëve dhe çështjet konkrete mbi të cilat është duke punuar.

6. Në caktimin e periudhës së transferimit të përkohshëm, Këshilli mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit të prokurorisë në tërësi, si dhe prokuroritë ndërmjet të cilave ndodh transferimi në veçanti. Në çdo rast, periudha e transferimit në kuptim të kësaj rregulloreje nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit.

7. Transferimi i përkohshëm kryhet me pëlqimin e prokurorit që transferohet. Në rastin kur asnjë prokuror nuk jep pëlqimin, transferimi i përkohshëm mund të bëhet edhe pa pëlqim, sipas kritereve të nenit 46/2, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. Në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm, prokurori rikthehet në pozicionin e mëparshëm.

9. Transferimi i përkohshëm nuk bëhet në rastet kur prokurori është nën efektet e një mase disiplinore.

KREU II TRANSFERIMI ME PËLQIM

Neni 6

Njoftimi i vendeve të lira për transferim të përkohshëm

1. Kur një prokurori është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka prokuror të disponueshëm, me kërkesë të prokurorisë në nevojë ose kryesisht, kur vlerësohet se nevoja e prokurorisë ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli njofton vendin e lirë të përkohshëm për transferim të përkohshëm ndërmjet prokurorëve që plotësojnë kriteret sipas nenit 5 dhe u bën thirrje prokurorëve për të dhënë pëlqimin.

2. Këshilli u komunikon zyrtarisht prokurorëve, që plotësojnë kriteret, thirrjen për dhënien e pëlqimit të cilët duhet të shprehen brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Nëse nevoja e një prokurorie, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një prokuror, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, fton fillimisht, për të dhënë pëlqimin atë prokuror që është i transferuar, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e prokurorisë ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme.

4. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera të parashikuara nga legjislacioni, për adresimin e nevojës në prokurorinë në të cilën synohet transferimi.

5. Transferimi me pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtme:

a) prokurori ose prokurorët, që japin pëlqimin fillimisht, duhet të jenë nga prokuroria me ngarkesën mesatare më të ulët për prokuror, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;

b) prokurori duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

Neni 7

Kërkimi i pëlqimit nga prokurori

1. Në rastin e krijimit të një pozicioni të lirë në një prokurori, në të cilën ka prokurorë të



transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij prokurori.

2. Në çdo rast tjetër të krijimit të një pozicioni të lirë në një prokurori në nevojë, dhënia e pëlqimit iu kërkohet të gjithë prokurorëve që përmbushin kriteret për pozicionin e lirë të përkohshëm të shpallur.

Neni 8

Verifikimi paraprak i plotësimin të kriterëve

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve të prokurorit që ka dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm.

Neni 9

Shqyrtimi i dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm

1. Në vlerësimin e rasteve për transferim të përkohshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, krahas verifikimit të plotësimin të kriterëve të transferimit nga ana e prokurorit që ka dhënë pëlqimin, vlerëson informacionet më të fundit të përgatitura nga Prokurori i Përgjithshëm lidhur me statistikën e ngarkesës së punës së prokurorëve, si dhe mendimin e drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionet prokurori në fjalë, lidhur me ngarkesën në punë të prokurorit, si dhe me cenimin e funksionalitetit të prokurorisë.

2. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim, brenda dy ditësh, mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Mendimi i drejtuesit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti, numrin total të prokurorëve që ushtrajnë funksionet në atë prokurori, seksionin nga i cili vjen prokurori, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e prokurorisë transferimi i prokurorit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën prokurori mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i drejtuesit të Prokurorisë nuk është përcaktues.

3. Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të cilët kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e prokurorit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij, Komisioni i

Zhvillimit të Karrierës përgatit një raport për çdo rast dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim dhe vendim duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm.

Neni 10

Vendimarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar përkohësisht prokurorin që ka dhënë pëlqimin pas shqyrtimit dhe propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë prokurorit dhe drejtuesve të prokurorëve.

2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të prokurorit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

KREU III

TRANSFERIMI PA PËLQIM

Neni 11

Fillimi i procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim

Kur nevojat e një prokurorie për prokurorë nuk mund të plotësohen nga skema e delegimit dhe as nga transferimi i përkohshëm me pëlqim i ndonjë prokurori, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës njofton Këshillin, i cili vendos për nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim të një prokurori.

Neni 12

Kushtet dhe kriteret e veçanta të transferimit pa pëlqim të prokurorit

1. Kur asnjë prokuror nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht në një prokurori, transferimi pa pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

a) prokurori ose prokurorët duhet të jenë nga prokuroria me ngarkesën mesatare më të ulët për prokuror, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;

b) prokurori duhet të jetë me përvojën më të pakët si prokuror në prokurorinë nga vjen;

c) prokurori duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.



2. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në prokuroritë e apelit do të bëhet së pari nga prokuroritë e apelit, sipas kritereve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

Neni 13

Identifikimi i prokurorit që do të transferohet pa pëlqim

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës kërkon nga Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesit e prokurorive informacionin e nevojshëm në zbatim të kësaj procedure.

2. Pas përcaktimit të prokurorisë me ngarkesën më të ulët, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 4, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë prokurori prokurorin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht. Në rastin e disa prokurorëve me ngarkesë më të ulët sipas kësaj pike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon për secilën nga këto prokurori prokurorin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

3. Në çdo rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson edhe mendimin e drejtuesit të prokurorisë ku ushtron funksionet prokurori në fjalë.

4. Drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, drejtuesi i prokurorisë dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të prokurorit. Mendimi i drejtuesit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e prokurorisë në tërësi dhe të prokurorit në veçanti, numrin total të prokurorëve që ushtrjnë funksionet në atë prokurori, seksionin nga i cili vjen prokurori apo fushën e së drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e prokurorisë transferimi i prokurorit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën prokurori mund të transferohet përkohësisht

duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i drejtuesit të prokurorisë nuk është përcaktues.

5. Në përfundim Komisioni përgatit një raport për transferimin pa pëlqim dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim, duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm dhe periudhën e transferimit.

Neni 14

Vendimarrja e Këshillit

1. Këshilli merr vendim për të transferuar përkohësisht pa pëlqim prokurorin pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë prokurorit dhe drejtuesve të prokurorive ndërmjet të cilave ndodh transferimi.

2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të prokurorit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

KREU IV TË FUNDIT

Neni 15

Përfitimet për shkak të transferimit të përkohshëm

Prokurori i cili transferohet përkohësisht sipas kësaj rregulloreje përfiton kompensim sipas parashikimeve të nenit 15/2, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 16

Regjistri i transferimeve

Këshilli krijon pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore një regjister të posaçëm i cili përmban informacion mbi prokurorët e transferuar sipas kësaj rregulloreje dhe periudhën e transferimit.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë